



Legalizimi i çertifikatave të Republikës së Kosovës

Legalizimi i shërben synimit për pëdorim të çertifikatave kosovare të gjendjes civile në Gjermani brenda qarkullimit të tyre mes shtetesh. Për të shmangur shpenzimet eventuale të panevojshme, rekomandohet që fillimisht të siguroheni nga institucioni përkatës brenda Gjermanisë, nëse kërkohet domosdoshmërisht legalizimi i çertifikatave. Legalizimi i aktykimeve të shkurorëzimit nuk është i mundur.

Mund të legalizohen vetëm çertifikatat e gjendjes civile, të cilat iu referohen gjendjeve civile (d.t.th. lindjeve, lidhjeve të martesave dhe vdekjeve) që kanë ndodhur pas datës 18.02.2013 (Lansimi i Regjistrimit Qendror i të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës). Data e lëshimit të çertifikatës është e parëndësishme.

Për çertifikata të tjera zyrtare nga Republika e Kosovës nuk ka parakushte për legalizim. Për këtë arsye, me miratim të Ministrisë Federale për Punë të Jashtme këto çertifikata nuk legalizohen. Në raste të domosdoshme mund të bëhet një verifikim i çertifikatave (shih fletëinformacionin e veçantë).

Parakusht për legalizimin përfundimtar të një çertifikate nga ana e ambasadës është vërtetimi paraprak nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës:

Ministria e Punëve të Brendshme Agjencia e Regjistrimit Civil
Rruga: "Luan Haradinaj" p.n.
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Zyra për Komunikim Publik
Tel: + 381 (0) 38 200 19 545
E-Mail: zip-mpb@rks-gov.net

Gjuhët e korrespondencës janë: gjuha shqipe, serbe dhe angleze.

Çertifikatat origjinale që bartin vulën e verifikimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës mund të legalizohen në Ambasadën Gjermane në Prishtinë. Nëse duhet të legalizohet një ekstrakt nga Regjistri Qendror i të Dhënave Personale, dokumentit patjetër i duhet bashkangjitur çertifikata e lindjes. Përkthimi i çertifikatës në gjuhën gjermane nuk është i domosdoshëm.

Çertifikata që synohet të legalizohet duhet të dorëzohet në ambasadë pas caktimit paraprak të terminit nëpërmjet faqes: www.pristina.diplo.de. Tarifa për legalizim është 25 euro për çdo çertifikatë të gjendjes civile.

Pronari i çertifikatës nuk duhet patjetër të paraqitet personalisht (nëse p.sh. është me qëndrim në Gjermani). Në rast të paraqitjes së çertifikatës nga një person tjetër, që nuk është pronari i çertifikatës, apo prindërit e tij/saj, atëherë personi i autorizuar, me këtë rast, përveç autori-

zimit të nënshkruar nga pronari i çertifikatës duhet të dorëzojë edhe një fotokopje të pasaportës së udhëtimit apo të letërnjoftimit të pronarit të çertifikatës.

Këto të dhëna jepen në bazë të informatave, të cilat i ka pasur në dispozicion Ambasada Gjermane në Prishtinë në kohën e publikimit. Nuk merret përgjegjësi për plotësinë, saktësinë dhe aktualitetin e informatave.